



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit:21.0.1 -2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderren, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti mbështetur nga Mujë Gashi (Udhëheqës i ekipit)) dhe Arian Haxhaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
5 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	18
6 Konkluzioni i përgjithshëm	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	21
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Kuvendin e Republikës së Kosovës (më tutje KRK). Unë do të doja të falënderoja KRK- në për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 - Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

Pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë. (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).*

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga KRK. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Sistemi i kontrolleve të brendshme të KRK-së është dizajnuar në mënyrë të duhur. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak, sidomos në fushën e prokurimit dhe të

menaxhimit të pasurisë, ka ndikuar në funksionalizimin e mëtutjeshëm të sistemit të kontrollit në mënyrë efikase.

Ne ishim në gjendje të kemi siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive. Megjithatë, testimet e kryera kanë identifikuar akoma disa mangësi në disa fusha të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Mangësitë janë të shpjeguara më në detaje më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin KRK-në në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se adresimi i tri (3) nga katër (4) rekomandimet e dhëna tregon, që KRK i ka kushtuar më shumë vëmendje rekomandimeve tona nga viti paraprak dhe si rezultat i kësaj është arritur një progres i theksuar.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të KRK-së dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Kuvendit janë si në vijim:

- Të sigurojë që ka kryer vetëvlerësim e punës dhe ka përgatitur raporte për kontrollet e brendshme për të vlerësuar proceset dhe procedurat aktuale të ndërlidhura me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të instaloj mekanizma monitorues të aktiviteteve të prokurimit për të siguruar që kontrata realizohet sipas afateve të përcaktuara dhe si pjesë të këtij procesi të marr në konsideratë aplikimin e ndëshkimeve si masë parandaluese/ndëshkuese për vonesat e mundshme; dhe
- Të siguroj që NJAB fokusohet në auditimin e proceseve dhe aktiviteteve të vitit aktual, ku menaxhmenti mund të informohet më në hollësi për aktivitetet që janë në proces dhe të ndërmerr masa për përmirësim.

Kryetari i Kuvendit është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e KRK-së të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për KRK-në. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë masë mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

KRK ka përgatitur PVF-të e saj në përputhje me kornizën e raportimit të jashtëm në kuptim të përdorimit të formatit të duhur dhe kohës së paraparë për raportim, dhe kërkesave tjera.

Përshkrimi

Pasqyra vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuara raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Janë dorëzuar në MF - Thesar brenda afatit kohor me datën 31.01.2013;
- Janë përgatitur si kopje fizike edhe si elektronike;
- Janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar; dhe
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03 / L-048.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura gjatë auditimit të 9 mujorit në lidhje me kornizën raportuese në memon tonë të datës 13/12/2012 janë adresuar nga KRK.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgatitur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. KRK ka përdorur formatin standard për raportim, dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat në pajtueshmëri me kornizën për raportim.

Përshkrimi

PVF-të e dorëzuara në Thesar me 31 Janar 2013 ishin të cilësisë së mirë.

Marrë parasysh atë që u tha më lart - Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, për draft PVF-të e dorëzuar në Qeveri, mund të konsiderohen të plota. Po ashtu kemi konstatuar se shpalosjet narrative kanë siguruar plotësinë e informacioneve shpjeguese sa i përket saktësisë së pohimeve në PVF.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Opinioni i AP-së është:

Pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë. (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).*

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Kryetari i Kuvendit i ka kushtuar më shumë vëmendje rekomandimeve tona nga viti paraprak dhe si rezultat i kësaj është arritur një progres i theksuar në vitin aktual në këtë drejtim, sidomos në fushën e procedurave të prokurimit dhe tek menaxhimi i pasurive.

Përshkrimi

Në raportin e auditimit të PVF-ve të KRK-së për vitin 2011 ne kemi dhënë rekomandime lidhur me përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. KRK ka përgatitur një Plan Veprimi (PV) për adresimin e tyre duke theksuar se të gjitha rekomandimet duhet të adresohen.

Raporti ka rezultuar me 4 (katër) rekomandime kryesore. KRK kishte adresuar plotësisht 3 (tri) rekomandime dhe 1 (një) ishte adresuar pjesërisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga KRK-ja për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët.

Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Megjithatë kërkohet një vlerësim i vazhdueshëm i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga KRK.

Aty ku është e përshtatshme, ne gjithashtu e konsiderojmë kryerjen e vetë-vlerësimit të KRK-së drejt përmirësimit të vazhdueshëm në mënyrë që kontrollet të funksionojnë në mënyrë efektive.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Buxheti KRK-së për vitin 2012 është shpenzuar për qëllimet e planifikuara. Realizimi i buxhetit ishte në masën prej 97% në krahasim me buxhetin final. Kjo tregon performancë të mirë të nivelit të shfrytëzimit të buxhetit.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për KRK dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Burimet e Fondeve:	16,082,651	17,002,911	16,492,680	15,932,921	8,608,297
Granti i Qeverisë-Buxheti	16,082,651	16,984,251	16,474,020	15,931,298	8,601,715
Donacionet e Jashtme	-	18,660	18,660	1,623	6,582

Në tabelën 1 janë paraqitur mjetet e buxhetuara dhe të shpenzuara në total, sipas burimeve të fondeve. Buxheti final në krahasim me atë fillestar dallon si pasojë e ndryshimeve të ndodhura buxhetore gjatë vitit 2012 dhe përfshirjes së donacioneve nga qeveria Zvicerane dhe UNDP-ja. Po ashtu janë paraqitur edhe mjetet e shpenzuara nga granditë e qeverisë dhe nga donacioni.

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën e mësipërme mund të vërejmë se granti qeveritar dhe donacionet e jashtme ishin burimi kryesor i financimit të aktiviteteve të KRK-së.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	16,082,651	17,002,911	16,492,680	15,932,921	8,608,297
Pagat dhe Mëditjet	5,275,660	5,329,460	5,314,910	5,722,683	4,503,117
Mallrat dhe Shërbimet	1,284,325	1,468,843	1,384,208	1,414,769	1,218,448
Komunalitë	221,000	177,000	176,393	163,639	202,010
Subvencionet dhe Transferet	8,270,000	8,925,000	8,924,999	7,904,999	1,892,219
Investimet Kapitale	1,031,666	1,102,608	692,170	726,831	792,503

Përderisa në total, performanca e ekzekutimit të buxhetit ishte e mirë, në nivel të kategorive për vitin 2012, në përjashtim të investimeve kapitale, ku shpenzimet e realizuara në krahasim me buxhetin final ishin në masën prej 63%. Shkaqet e shfrytëzimit të buxhetit në këtë nivel ishin se projektet e parashikuara për investime kapitale, edhe pse

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

ishin kontraktuar nuk ishin realizuar deri në fund të vitit, dhe si rrjedhojë edhe pagesat e ndërlidhura me këto projekte nuk ishin kryer.

Tabelat e mësipërme tregojnë se:

- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 920,260€. Siç shihet edhe nga tabela me lartë, përveç kategorisë së shpenzimeve komunale që kanë pësuar zvogëlim në vlerë prej 44,000€, të gjitha kategoritë tjera janë rritur me rishikim të buxhetit dhe lëvizjeve tjera buxhetore. Kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 53,800€, kategoria mallra dhe shërbime për 184,518€, subvencionet dhe transferet për 655,000€ dhe kategoria për investime kapitale në shumë prej 70,942€;
- Me qëllim të subvencionimit shtesë të RTK-së, me vendim të Qeverisë nr. 12/110 të datës 26.12.2012, Kuvendit ju kanë ndarë mjete shtesë në shumë prej 550,000€ në kategorinë e Subvencioneve. Këto mjete Kuvendi i ka alokuar tek RTK-së sipas rekomandimit nr. 04/R-125/k të Kryetarit të Kuvendit të datës 31.12.2012; dhe
- Donacionet e pranuar në mbështetje të Kuvendit në shumë prej 18,660€, KRK i ka shpenzuar 14,200€ për kategorinë paga dhe mëditje ndërsa për mallra dhe shërbime 4,460€.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

KRK, ka përmbushur kërkesat ligjore për raportim të jashtëm. Të gjitha raportet e kërkuara janë dorëzuar brenda afatit të caktuar kohor.

KRK ka marr në konsideratë këshillën tonë në fazën e përkohshme dhe si rrjedhojë ka kryer një proces të pjesërishëm të vetëvlerësimit, i cili do të zhvillohet më tutje në të ardhmen me mbështetje nga Ministria e Financave. Procesi fillestar i vetëvlerësimit është një zhvillim pozitiv.

Përshkrim

KRK ka përmbush obligimet për raportim të jashtëm për fushat në vijim, si:

- Ka përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF-së;

-
- Kërkesat Buxhetore;
 - Ka përgatitur dhe ka dorëzuar me kohë Pasqyrat Nëntëmujore Financiare;
 - Ka përgatitur dhe dorëzuar në ZAP planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
 - Ka përgatitur planin preliminar dhe final të prokurimit për vitin 2012, si dhe ka dorëzuar me kohë në APP; dhe
 - Ka përgatitur raportet mbi borxhet e papaguara dhe i ka dorëzuar me kohë në MF.

Siç shihet, KRK ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm me cilësinë e duhur dhe duke respektuar afatet kohore, përveç kompletimit të raportit për vetëvlerësim dhe kontrole të brendshme.

Rekomandimet

1. Çështja - Raportet mbi kontrollet e brendshme, përfshirë raportin e vetëvlerësimit - Prioriteti - i rëndësishëm

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Gjatë procesit të auditimit, na është prezantuar një raport i bërë nga ana KRK-së lidhur me vetëvlerësimin e punës vetëm nga një sektor por jo edhe vetëvlerësimi i bërë edhe nga sektorët tjerë, si kërkesë e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. |
| Rreziku | Mos aplikimi i procesit të vetëvlerësimit e bën të vështirë përcaktimin e rrezikut për efektivitetin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për të gjithë sektorët në kuadër të tij, në përkrahjen e plotësisht të objektivave të tyre të punës. |
| Rekomandimi 1 | Do të ndërmerren hapat e duhur që të siguroj se janë përgatitur raportet për vetëvlerësimin dhe kontrollet e brendshme për të gjithë sektorët e KRK-së. |

4.4 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Rezultatet e testeve tona kanë treguar se Kuvendi ka vendosur kontrolle të mira në lidhje me proceset e shpenzimeve prej inicimit të kërkesës deri tek ekzekutimi i kontratave. Nga mostrat e testuar kemi marrë siguri se kontrollet kanë funksionuar mirë.

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Zyrtari i prokurimit kishte hartuar planin e prokurimit për vitin 2012 dhe të njëjtin e ka dërguar në APP. KRK për vitin 2012 kishte realizuar prokurime që kanë rezultuar me nënshkrimin e 91 kontratave.

Ne kemi bërë një përzgjedhje prej 9 mostrave për testimin e procedurave të prokurimit si dhe 55 mostrave në listën e pagesave. Prej tyre 10 mostra përfshijnë kategorinë e investimeve kapitale në vlerë prej 444,503€, ndërsa 45 nga kategoria mallra dhe shërbime në vlerë prej 283,098€.

Rekomandimi

2. Çështja - Mos kryerja e furnizimeve në afatin e përcaktuar me kontratë - Prioritet-tjetër

E gjetura Tek kontrata për “Furnizim me goma për veturat zyrtare”, të nënshkruar me datën 25.06.2012 kemi vërejtur se furnizimi nuk është bërë brenda afatit kohor siç parashihet me kontratë. Sipas kontratës furnizimi me goma vere ishte paraparë të kryhet më së largu deri më 06.07.2012, ndërsa furnizimi në vlerë prej 2,062€ është kryer katër muaj më vonë (më 06.11.2012). KRK nuk kishte aplikuar gjobat në rast të vonesës në furnizim.

Rreziku Mos kryerja e furnizimeve brenda afatit kohor siç parashihet me kontratë mund të shkaktojë pengesa në realizimin e pagesave dhe kryerjen e veprimtarisë.

Rekomandimi 2 Të siguroj se janë instaluar mekanizma monitorues të aktiviteteve të prokurimit për të siguruar që kontrata realizohet sipas afateve të përcaktuara dhe si pjesë e këtij procesi të marr në konsideratë aplikimin e ndëshkimeve si masë parandaluese/ndëshkuese për vonesat e mundshme.

4.4.2 Shpenzimet tjera

Përshkrim

Gjatë vitit 2012, KRK për qëllime të udhëtimeve zyrtare kishte shpenzuar 370,316€ apo 27% nga mjetet e shpenzuara në kategorinë mallra dhe shërbime.

KRK ka arritur t'i zbatoj plotësisht kërkesat ligjore lidhur me respektimin e afateve për mbylljen e avanseve për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti nga kjo kategori për vitin 2012 ishte 5,329,460€, ndërsa ishin shpenzuar 5,314,910€, apo pothuajse 100% të buxhetit final.

Sipas Ligjit të Buxhetit, KRK në fillim të vitit i kishte të aprovuar 331 pozita, ndërsa në fund të vitit kishte 318 të punësuar. Të punësuarit e KRK-së e përbëjnë: 120 Anëtarët e Kuvendit, 168 të punësuar në Administratën e Kuvendit dhe 30 Staf Mbështetës Politik.

Kryesia e KRK-së me datën 12 nëntor kishte nxjerrë vendimin nr. 04-V-263, për kompensimin shtesë për të gjithë nëpunësit e Administratës së KRK-së në shumë prej 420€ dhe stafit mbështetës politik në shumë prej 300€, për angazhimin e shtuar në mbështetje të organeve të Kuvendit për realizimin e programit të punës.

Vendimi për kompensim shtesë është kryer nga kategoria paga dhe mëditje për stafin administrativ dhe stafit mbështetës politik. Ky kompensim ishte planifikuar dhe përfshirë në ligjin e buxhetit për vitin 2012. KRK nuk kishte nxjerrë akt të veçantë i cili do të rregullonte orarin dhe kushtet specifike për kompensimin e punonjësve, kërkesë kjo e Ligjit të shërbyesve civil. Megjithatë, në prill 2013, Kryesia e KRK-së kishte aprovuar aktin e veçantë në bazë të cilit është rregulluar orari i punës dhe kompensimi shtesë për nëpunësit civil të administratës së Kuvendit.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operohen në nivel intern nga KRK-së kanë të bëjnë me:

- mbajtjen dhe azhurnimin e rregullt të dosjeve të punësuarve nga zyra e personelit;
- sektori i financave është njoftuar rregullisht dhe me kohë lidhur me ndryshimet në lidhje me pagat dhe mëditjet ; si dhe

-
- për të gjitha ndryshimet e ndodhura janë lëshuar vendimet, nga Sekretari apo Drejtori i Administratës, në bazë të të cilëve janë bërë kompensimet për shtesat dhe angazhimet e kryera jashtë orarit të rregullt të punës. Pagesa e tyre është bërë përmes sistemit të pagave.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Konkluzion i përgjithshëm për subvencionet

Pagesat e subvencioneve janë kryer në harmoni me procedurat e kërkuara ligjore. Subvencionimi i RTK-së është bërë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 02/L-47 për RTK-në dhe Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e vitit 2012.

Përshkrimi

Kemi testuar kategorinë e Subvencioneve të parashikuara me buxhet fillestar, me rishikim të buxhetit dhe me lëvizjet tjera buxhetore në vlerë prej 8,925,000€, ndërsa KRK gjatë vitit kishte shpenzuar 8,924,999€.

KRK gjatë vitit kishte ndarë subvencione për RTK- së në shumë prej 8,909,999€, ndërsa subvencionet për entitetet tjera ishin në shumë prej 15,000€. Këto subvencione Kuvendi i kishte dedikuar kryesisht në formë ndihmash dhe përkrahje financiare për OJQ dhe Shoqata në bazë të kërkesave drejtuar Kuvendit.

Testet tona rezultuan se subvencionet janë shpenzuara në bazë të vendimeve të nxjerra paraprakisht dhe të aprovuara nga personat e autorizuar. Pagesat ishin aprovuar dhe certifikuar nga personat kompetent dhe pagesat ishin bërë në llogarinë e përfituesit.

Testimet e shpenzimeve të subvencioneve nuk kanë rezultuar me ndonjë parregullsi.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Mund të konkludojmë se KRK në krahasim me vitet paraprake ka bërë progres në drejtim të menaxhimit të pasurisë së saj. Ka bërë azhurnimin e regjistrave të pasurisë, duke i larguar nga regjistrat pasuritë që nuk janë pronë e KRK-së. Secili zyrtar i KRK-së është ngarkuar me inventarin dhe pajisjet e tyre në shfrytëzim. Më këto veprime ka arritur të krijoj siguri për sa i përket saktësisë së informatave në regjistër kontabël dhe menaxhimin e pasurisë në pajtim të plotë me kërkesat ligjore.

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mënyra e evidentimit dhe menaxhimi i pasurive jo financiare në KRK është në pajtim me kërkesat e UA nr.21/2009 mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive qeveritare.

KRK, ka të dizajnuar regjistrin e brendshëm të pasurisë i cili është në përputhje me kërkesat ligjore. Zyrtari i pasurisë ka arritur të regjistroj të gjitha pasuritë si dhe ka azhurnuar edhe regjistrin kontabël (SIMFK).

Vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 7,056,440€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 606,258€. Në PVF pasuritë janë paraqitur sipas vlerës së tyre neto.

KRK -ja në përputhje me UA nr 21/2009 në fund të vitit 2012, kishte formuar komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive, këto komisione kishin përgatitur raportet siç kërkohet me këtë UA.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi auditimin e brendshëm

KRK, ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi. Komiteti i auditimit (KA) dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) janë funksional dhe kanë operuar në bazë të planit dhe përgjegjësi të caktuara.

Puna e Auditimit të Brendshëm (AB) në vitin 2012 ka mbuluar kryesisht vetëm operacionet e vitit 2011, dhe pak kishte trajtuar aktivitetet për vitin 2012. Aktiviteti i tij vetëm pjesërisht e ka mbështetur menaxhmentin në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të përgjithshme të kontrollit të brendshëm.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së AB-së dhe aktivitetet e KA-së. Përveç kësaj, ne i kemi shqyrtuar veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga këto funksione të auditimit.

KRK, ka të themeluar NJAB, e cila aktivitetin e saj e kryen vetëm me një auditor.

NJAB, kishte përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2012, i cili është aprovuar nga menaxhmenti i KRK-së. NJAB kishte planifikuar katër auditime, për fushat: procedurat e prokurimit, buxheti dhe shpenzimet buxhetore, menaxhimi i resurseve njerëzore dhe implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

Për periudhën e vitit 2012, NJAB kishte kryer auditime në këto fusha: auditimin e buxhetit, pagesat dhe menaxhimi i pasurisë që ka mbuluar periudhën e vitit 2011, auditimit të fushës së prokurimit për periudhën shtator 2011 deri me 31 Gusht 2012 si dhe raportin rreth implementimit të rekomandimeve nga auditimet e mëhershme.

Ndërsa, në fillim të vitit 2013 NJAB kishte kryer edhe raportin “Menaxhimi i resurseve njerëzore” por që akoma nuk ishte diskutuar nga Komiteti i auditimit.

Po ashtu, me kërkesë të KRK-së, NJAB kishte kryer auditimin e “Servisimi i pajisjeve të Teknologjisë Informativë” që kishte mbuluar periudhën e vitit 2011 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2012.

Këto auditime i kanë trajtuar çështjet përkatëse dhe kanë dhënë rekomandimet adekuate.

KA është funksional dhe përbëhet prej tre anëtarëve. Komiteti, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tri takime. Në takimet e mbajtura është diskutuar për vlerësimin e riskut në bazë

të raporteve të pranuar nga zyrtarët e Kuvendit, planin strategjik të NjAB për 2013-2015, planin e punës për vitin 2013 dhe kanë shqyrtuar dhe miratuar raportin e NjAB-së për servisimin e pajisjeve të teknologjisë informative.

Rekomandimet

3. Çështja - Fokusimi i auditimit të brendshëm në aktivitetet aktuale - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Auditimet e brendshme kryesisht kanë të bëjnë me veprimtarinë e vitit 2011 dhe pjesërisht kishin përfshirë aktivitetet aktuale që lidhen me vitin 2012.

Rreziku Mungesa e përqendrimit mbi aktivitetet në proces dhe atyre aktuale nga NJAB ka rezultuar që KRK-së jo gjithherë të ketë informacione lidhur me çështjet aktuale mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme gjatë vitit 2012.

Rekomandimi 3 Të siguroj se NJAB fokusohet më shumë në vitin aktual, ku KRK mund të informohet më në hollësi për aktivitetet që janë në proces dhe të ndërmerr masa për përmirësim.

4. Çështja - Trajtimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nga Komiteti i auditimit- Prioriteti- tjetër

E gjetura Në takimet e mbajtura, Komiteti i auditimit nuk kishte trajtuar procesin e adresimit të rekomandimeve të dhëna nga ZAP dhe NJAB.

Rreziku Mungesa e vëmendjes nga KA në adresimin e rekomandimeve të dala nga auditimet e ZAP dhe NjAB do të ndikoj në efikasitet të dobët të proceseve për përmirësim financiar. Kjo gjithashtu do të mundësoj përsëritjen e mangësive.

Rekomandimi 4 Do të kërkoj nga Komiteti i auditimit që në takimet e tyre me prioritet të trajtohen rekomandimet nga auditimet, hapat e ndërmarr dhe niveli i adresimit të tyre.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Sistemit të Auditimit të Brendshëm. Kjo mund të përmblihet si:

Sistemet e kontrolleve të brendshme në KRK janë mirë të dizajnuara. Ato ofrojnë bazë për të siguruar përdorim efektiv dhe efikas të parasë publike dhe/ose dhënien e informatave të cilësisë së mirë, të cilat mbështesin vendimmarrjet e menaxhmentit.

PVF-të e KRK-së janë në linjë me kornizën ligjore për raportim financiar dhe Rregullën Financiare nr. 07/2011. PVF-të e dorëzuara në Thesar më 31 janar 2013 ishin të cilësisë së mirë. KRK, i ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm. Raportet janë dorëzuar brenda periudhës së kërkuar.

KRK-së ka përgatitur një Plan Veprimi (PV) për adresimin e rekomandimeve të mëhershme, në bazë të cilit edhe kishte ndërmarrë veprime konkrete, mirëpo mbetet sfidë edhe më tutje implementimi i tyre i plotë.

Përkundër kësaj, ne kemi identifikuar akoma disa mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e paraqitura në kapitujt më lartë. Mangësitë e vërejtura mund të rezultojnë me mos arritjen e objektivave të përcaktuara.

KRK-ja duhet të shtoj përpjekjet për t'i zbatuar rregullat e MFK-së në të gjitha strukturat, programet, operationet dhe proceset e menaxhuara duke respektuar parimet e ligjshmërisë dhe menaxhimit financiar të cilat ofrojnë siguri të arsyeshme se rreziqet për organizatën menaxhohen në mënyrë efektive.

KRK-ja, ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi. Komiteti i auditimit dhe NjAB janë funksional, por aktivitetet e tyre duhet më shumë të drejtohen në proceset aktuale, ku ndikimi në përmirësimet e tyre do të ishte më me ndikim.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuarra të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Planifikimi dhe Ekzekutimi i buxhetit	Në mënyrë të vazhdueshme përcjell dhe analizon dinamikën e rrjedhjes së parasë me qëllim që të evitohet aq sa është e mundur ngarkimi i tepërt i muajve të fundit të vitit me pagesa	Po		
2. Blerjet përmes prokurimit	<ul style="list-style-type: none"> Të bëhen njoftime për dhënie të kontratave konform kërkesave ligjore; Kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të ketë kaluar koha e paraparë pas njoftimit për dhënie të kontratës; Janë specifikuar kushtet e veçanta në të gjitha kontratat e nënshkruara, në mënyrë që mbikëqyrja e realizimit të tyre të jetë më e mirë; dhe Janë nënshkruar kontratat, vetëm me ekonomik të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në dosjet e vendit operatorët 	Po		

3.Menaxhimi i pasurisë	Regjistrat e inventarit dhe pajisjeve që ka në shfytëzim secili zyrtar i Kuvendit janë azhurnuar për çdo vit, në mënyrë që secili punonjës të dijë se me çfarë është i ngarkuar	Po		
4. Auditimi i brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Komiteti ka mbajtur takime të rregullta, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që NjAB-së t'i ofrohet përkrahje më e madhe; dhe • Të gjitha rekomandimet që kanë dal nga auditimet e brendshme të adresohen 		Komiteti i auditimit me prioritet duhet trajtuar rekomandimet e dhëna nga auditimet e kryera si dhe auditimi i brendshëm të fokusohet me shume në auditimet e aktiviteteve në proces.	